



Prishtinë, 20 shkurt 2015  
Kodi i ZRRE-së: V\_684\_2015

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 par. 1, nenin 8, nenin 9, nenin 11 dhe nenin 14 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-604-2013 dt. 27 dhjetor 2013 për lëshimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë "AIR- ENERGY" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, në lokacionin "Wind Park-KITKA", komuna e Kamenicës, dhe
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në Skemën Mbështetëse për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, në lokacionin "Wind Park-KITKA", komuna e Kamenicës, të datës 22.01.2015 të shoqërisë "AIR-ENERGY" SH.P.K., me adresë: "Isa Boletini", p.n. Komuna Gjilan, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "AIR – ENERGY" SH.P.K., dhe **PRANOHET** në Skemën Mbështetëse operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, në lokacionin "Wind Park-KITKA", komuna e Kamenicës.
- II. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet në mënyrë automatike Tarifa Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
- III. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.




## Arsyetim


- ZRRE me datë 22.01.2015 nga shoqëria “AIR – ENERGY” SH.P.K. ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, në lokacionin “Wind Park-KITKA”, komuna e Kamenicës.
  - Bordi i ZRRE-së me datë 27 dhjetor 2013, shoqërisë “AIR – ENERGY” SH.P.K., i ka lëshuar Vendimin V-604-2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike.
  - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse dhe analizimit të saj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit V-604-2013 dt. 27 dhjetor 2013 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me të cilën i është lëshuar Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, shoqërisë “AIR – ENERGY” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

### Bordi i ZRRE

  
Enver Halimi, kryesues

  
Merita Kostari, anëtare

  
Krenar Bujupi, anëtar